

Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Maskat torturuan dhe grabitën nënë e bir në banesë, banorët e fshatit të indinjuar: S'na kishin vjedhur as një pulë. Shteti të gjejë autorët, ndryshe...

02 Tetor, 2022 11:21



Madhësia e tekstit: - +

Banorët e fshatit Dom në Klos janë indinjuar me ngjarjen e rëndë që ndodhi gjatë natës ku nënë dhe bir pasi u lidhën dhe dhunuan, u grabitën në banesën e tyre. Ngjarja ndodhi pas orës 2:00. Gazetari Enver Doçi ka siguruar për **BalkanWeb** dëshmitë e bashkëfshatarëve të familjes Lleshi.

Banorë e zonës, që kanë lidhje fisnore me familjen që ra pre e grabitjes, pohuan se nuk kishin pasur asnjë rast të tillë, madje as vjedhje më banale në këtë fshat.

BW

Download on the App Store

GET IT ON Google Play

LAJMET E FUNDIT

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

"Është një ngjarje e pazakontë, për fshatin tonë, për lagjen tonë, Në këto 75 vite nuk mbaj mend të jetë vjedhur një pulë. Jemi habitur. Kemi ardhur që në orën 3 të mëngjesit këtu. Policia po punon, por duhet t'i gjejë. Ne nuk dimë gjë se si ka ndodhur. Shyqyr që ka shpëtuar djali, tani të vërë dorë shteti. Zonja e shtëpisë tha se e kanë hapur me çelës autorët valixhen, kanë lidhur nënë e bir. Shyqyr që shpëtuan. Tani e ka në dorë shteti.", tha një prej banorëve të fshatit.

Një tjetër banor i bëri thirrje autoriteteve që të gjejnë autorët, në të kundërt duhet të marrin masa vetë.

"Edhe një pulë nuk është vjedhur. Kjo familje është më e rregullta në katund. Ata punojnë në shtëpinë e vetë. Erdhëm këtu nuk gjetëm asnjë njeri. Gjetëm nënën dhe djalin, se e lidhën dhe i ranë. Shyqyr që janë gjallë. Djalin e çuan në spital e kanë mjekuar. Qeveria duhet të ndërhyjë, ose të rregullojë ose ta dimë dhe ne. Me mbajt armë dënohem, po ta dimë dhe ne të marrim masa. Ne as derën se çelim, por duhet të vëmë mend tani. Kërkojmë që personi të dënohet maksimalisht dhe mos të kemi mëshirë. Kjo familje nuk ka bërë asnjë të keqe të bëhet ai veprim.", tha ai.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit **"Balkanweb"** mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: grabitje klos maskat

TË NGJASHME

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

KATEGORIA VIDEO

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

02 Tetor, 2022

Klodiana Lala | 02 Tetor, 2022

BalkanWeb	EMISIONE NEWS24	KATEGORI	MEDIAT E HUAJA
	Alert	Fillimi	New York Times
	Autoktonët	Shqipëria	Guardian
	Dola te Ola	Kosova	WEB BBC
	Emissioni Vila 24	Rajoni	WEB CNN
	Fit Station	Sport	REUTERS
	Frontline	Bota	Washington Post
	Jeta_pa_filtr	Kulturë	Times Online
	Kjo Javë	Metropol	Financial Times
	Klinika 24	Analiza	WEB Yahoo
	Koha për t'u zgjuar	Teknologji	WEB MSN
	Me zemër të hapur		USA Today
	Në mëngjes me Klarkun		
	Në shënjestër		
	Open		
	Pikat mbi i		
	Rrugëtim me Anilën		
	Sport News		
	Sport News Plus		